



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.635/6 prot.

Datë 10.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 497/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

**Ankimues:**

Operatori BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k me NIPT M01406022R dhe NIPT K82020002A, me adresë: Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2.

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimes BOE "WOW DIGITAL & First" sh.p.k, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30-12-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt "Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)", me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-01-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

II.2. Në datën 12.02.2026, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "ENTECH.AL" SH.P.K, 0 Lek skualifikohet
2. BOE "WOW DIGITAL & First" SH.P.K 67,700,000 Lek skualifikohet  
(*"WOW ska fare pune te ngjashme kurse first ka vetem fature qe permbush vleren. d)  $\geq 1$  i certifikuar nga prodhuesi për pajisje server (nivel Arkitekt) ose ekuivalente Nuk plotësohet (me provat aktuale) xxxxx - Azure Solutions Architect Expert: është "arkitekt" por për cloud (Azure), jo "pajisje server/hardëare". Kjo pikë kërkon certifikime të prodhuesve të serverëve fizikë (HPE/Dell/Lenovo/Cisco UCS, etj.) ose ekuivalent shumë të qartë "server hardëare architecture". e)  $\geq 2$  AI Foundation specialist "nga prodhuesi" ose ekuivalente Nuk plotësohet FIRST: xxxx – Microsoft Certified: Azure AI Engineer Associate (1 person i sigurt "producer" dhe permbushet) WOW: xxxx - "Bazat dhe Principet e Inteligjencës Artificiale" nga IriSoft (trajnim/vendor lokal, jo "prodhues" tip Microsoft/Oracle/Google/AËS, etj). 1. Operatori ekonomik WOW DIGITAL nuk paraqet deshmi për shërbimet të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH. 2. Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, NUK vërteton se ka punonjes me Çertifikate perkatese si meposhte: d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent; e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si specialist në fushën AI Foundation ose ekuivalent;*)

3. BOE “3i-Solution & CCS” SH.P.K,	78,840,810 Lek	Kualifikohet
4. “SMOVATAKSI” & “G.P.G.COMPANY” SH.P.K,	85,668,692 Lek	Kualifikohet
5. “Advanced Business Solutions-ABS” SH.P.K,	86,810,000 Lek	Kualifikohet
6. “1UP Labs” SH.P.K,	95,405,000 Lek	Kualifikohet

II.3. Në datën 23-02-2026, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Në datën 27.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 635/2026 protokoll, datë 27.02.2026 e operatorit ekonomik BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471 12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i bdryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 635/1 prot., datë 02.03.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, kundërshton me anë të ankesës me 635/2026 protokoll, datë 27.02.2026, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.4.2. Me shkresën nr. 635/2 prot., datë 17.03.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP-së lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitura nga operatori ekonomik “WOW DIGITAL” SHPK me qëllim vijimin e trajtimit të ankesës së këtij të fundit në KPP.

II.4.3. Me shkresën nr. 9392/10 prot., datë 27.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 635/2 prot., datë 27.03.2026 me objekt “Informacion” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi K.SHA mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k duke kundërshtuar Vendimin e Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, me arsyen se: *“Sqarojmë se për kontratën e ngjashme, është paraqitur kontrata e ngjashme e anëtarit të boe First shpk e cila sic theksohet edhe nga KVO e përmbush këtë kriter disa fish i shumës së kërkuar në KVK të DST. Bazuar në LPP dhe DST, bashkimi i shoqërive bëhet për këtë shkak që i gjithë BOE të plotësojë kriteret e kualifikimit si një entitet unik i vetëm. Operatori Ekonomik boe WOW Digital shpk dhe First shpk, ka përmbushur kriteret në mënyrë reale, funksionale dhe të dokumentuar, bazuar në certifikime ndërkombëtare dhe kompetencë të plotë profesionale.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.3.1 të shtojcës 9 *“Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”*, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

*“Shtojca 9*

#### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**2.3.1.** *Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara.***
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara”.***

III.1.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kriterëve të kapacitetit teknik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “WOW Digital” sh.p.k & “First” sh.p.k ne sistemin e prokurimeve elektronike, konstatojmë se ky i fundit në përmbushje të kriterit 2.3.1 të sipërcituar ka paraqitur si më poshtë:

-Kontratë bashkëpunimi Nr. 414 prot, datë 29.01.2026, ndërmjet shoqërisë“WOW Digital” sh.p.k & “First” sh.p.k. Ndarja e punimeve për secilën nga shoqëritë pjesë e këtij bashkimi operatorësh...e shprehur në përqindje ndarja e punimeve do të bëhet si më poshtë:

Shoqëria “WOW Digital” sh.p.k do të realizojë 15% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.

Shoqëria “First” sh.p.k do të realizojë 85 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.

-Nga Verifikim ne SPE është dorëzuar ne kuadër të BOE dhe për funksion të kriterit 2.3.1, konkretisht nga operatori ekonomik “First” SHPK si më poshtë:

-Vërtetim realizimi kontrate nga autoriteti kontraktor publik ”AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT” leshuar më datë 29/01/2026, me përmbajtje:

*“Në datë 30/09/2024, ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Operatori FIRST, në cilësinë e Kontraktuesit, të identifikuar me numër unik të subjektit (NUIS) K82020002A, me administrator Z. Dh L , nënshkruar nr. 106 prot., datë 30/09/2024 me objekt "Sistemi i Kontrollit dhe Vlerësimit të Sigurisë Kibernetike për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike", me afat 24 muaj mirëmbajtje dhe 6 muaj implementim, me vlerë totale 167,999,998.80 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë me TVSH. Deri në datën 29/01/2026, Kontraktuesi, FIRST ka realizuar në përputhje me objektin e kontratës së sipërcituar detyrimet kontraktuale, në vlerën 152,379,814.67 lekë (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e katërbëdhjetë) me TVSH”.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

*a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “ 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në

mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 3 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

III.1.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, konstatojmë, se referuar kontratës së bashkëpunimit nr.414 prot, datë 29/01/2026, ndërmjet shoqërisë “First” SHPK & shoqërisë “WOW DIGITAL” SHPK, sipas Nenit 1 “Objekti i kësaj marrëveshje është krijimin një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive palë në këtë kontratë si dhe përcaktimi i masës së kontributit të secilës shoqëri..... Ndarja e punimeve për secilën nga shoqëritë pjese e këtij bashkimi operators është bashkangjitur kësaj kontrate bashkëpunimi Aneksi nr.1. palët bien dakort që raporti i ndarjes së punimeve të jetë si më poshtë:

Shoqëria “WOW Digital” sh.p.k do të realizojë 15% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.

Shoqëria “First” sh.p.k do të realizojë 85 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të sipërcituar, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “WOW Digital” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2.

Nga krahasimi i kriterit të kerkuar nga autoritet kontaktor i cili konsiston në vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 konkretisht është kërkuar, në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar ashtu sic dhe parashikuar nga autortieti kontraktor, në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikon, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës tre vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në

punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga anëtari i BOE, operatori ekonomik “First” SHPK për plotësimin e kriterit 2.3.1 *“Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të vërtetimit të sipërcituar, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i shërbimit në vërtetim, si dhe afatit të realizimit të tyre, të dhëna këto lehtësisht të konstatueshme nga vërtetimi i realizimit të kontratës se dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “First” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit.

Komisioni Prokurimit Publik pas shqyrtimit në themel të përmbushjes së tre komponentëve, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit tre vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm me objektin të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar, vërtetimi i realizimit të kontratës së dorëzuar nga OE “First” SHPK, i përmbushje të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “First” SHPK, janë realizuar në përputhje me objektin e kontratës detyrimet kontraktuale, në vlerën 152,379,814.67 lekë (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e katërbëdhjetë) me TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nente milion) leke pa TVSH. Sa më sipër, rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “First” SHPK, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqëruar të tyre, të paraqitura si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, se plotëson kriterin 2.3.1. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin/zërat e prokurimit por, edhe në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në

përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Nga bashkimi i operatorëve është përcaktuar ndarja e shërbimeve me 15% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt dhe 85 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt, KPP vlerëson se mbështetur në nenin 88, pika 3 i Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave të sipërcituar dhe neni 3 i kontrastës së bashkëpunimit të lidhur mes dy operatorëve ekonomik si anëtar të bashkimit të operatorëve, se pavarësisht ndarjes si më sipër të gjithë partneret kanë përgjegjesi të përbashkët sa i përket zbatimit të kontratës, e cila përfundimisht do të realizohet nga sipërmarrja e përbashkët ku në rastin konkret shoqëria “First” sh.p.k do të realizojë 85 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt dhe me dokumentacionin e paraqitur ka arritur të përmbushë pikën 2.3.3. Sikunder nga operatori ekonomik “First” SHPK operatori tjetër ekonomik i BOE “WOW Digital” SHPK nuk ka dorezuar asnjë fature apo vertetim realizimi kontrate ne përputhje dhe korrespondenc me përqindjen e tij të marë përsipër sipas kontratës së sipërmarrjes ku shoqëria “WOW Digital” sh.p.k do të realizojë 15% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt, ashtu sic dhe cituar ne pikën 3 të nenit 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, “Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”, cka çon në mospërmbushje të kriterit të kërkuar.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: *“Vendimi i Autoritetit Kontraktor përbën interpretim restriktiv të konceptit ose ekuivalente , cenon parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës dhe shton në mënyrë të tërthortë një kriter vendor-specific që nuk është i parashikuar në dokumentet e tenderit. Ky ankim mbështetet në: ? Nenin 3 të Ligjit nr. 162/2020 (parimi i proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë); ? Nenin 36 të LPP (specifikimet teknike dhe ekuivalenca); ? ? Nenet 77 dhe 79 të LPP (kapacitetet teknike dhe profesionale); Nenin 44 të VKM nr. 285/2021 Parimet e arsytimit administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative. Neni 36 është thelbësor në këtë çështje. Ai sanksionon se kur përdoret termi ose ekuivalente , autoriteti kontraktor ka detyrimin të pranojë çdo dokument apo certifikim që provon nivel të barasvlershëm funksional, pa u kufizuar në identitet formal. Ky parim është i konsoliduar në praktikën e KPP, ku është theksuar se ekuivalenca nuk vlerësohet mbi bazë emërtimi apo lëshuesi, por mbi bazë përmbajtjeje dhe competence reale. Sqarojmë se objekti i procedurës është ndërtimi i një platforme të inteligjencës artificiale, e cila përfshin arkitekturë infrastrukurore të avancuar, integrim sistemesh, menaxhim të dhënash, orkestrime GPU, virtualizim, mekanizma disponueshmërie të lartë dhe plane rikuperimi nga fatkeqësitë. Projekti nuk është kontratë servisimi fizik hardëare. Nuk përfshin mirëmbajtje komponentësh fizikë, zëvendësim pjesësh apo ndërhyrje në nivel BIOS. Ai kërkon arkitekturë sistemike dhe projektim infrastrukture. Kriteri i vendosur në DST lidhet me arkitekturë serverike dhe jo me ndërhyrje fizike hardëare. Certifikimi Azure Solutions Architect përfshin 1. Projektimin e arkitekturës infrastrukurore enterprise; 2. 3. 4. 5. 6. 7. High Availability dhe clustering; Disaster*

*Recovery dhe plane rikuperimi; integrim hybrid (on-premise + cloud); dizajn rrjetesh dhe segmentim sigurie; orkestrim infrastrukture dhe optimizim performance; planifikim kapacitetesh dhe shkallëzueshmëri. Këto janë kompetenca thelbësore për një platformë AI moderne, e cila operon mbi infrastrukturë të shpërndarë dhe kërkon integrim kompleks sistemesh. Në krahasim, një certifikim vendor hardëare Arkitekt fokusohet zakonisht në arkitekturë brenda ekosistemit të një prodhuesi të vetëm dhe nuk mbulon domosdoshmërisht arkitekturë hibride apo orkestrime multi-platformë. Nga pikëpamja teknike, certifikimi i paraqitur nga OE është plotësisht i barasvlershëm dhe në disa aspekte më i gjerë. Mbi certifikimin AI Foundation, DST kërkon AI Foundation ose ekuivalent . Nuk përcakton prodhues të caktuar, nuk kërkon model unik certifikimi dhe nuk vendos detyrimisht provim vendor. OE ka paraqitur program të dokumentuar që përfshin konceptet themelore të Machine Learning, ciklin jetësor të modelit, menaxhimin e të dhënave, arkitekturën e implementimit dhe integrimin me sisteme ekzistuese. Autoriteti Kontraktor nuk ka analizuar përmbajtjen teknike të programit, por vetëm lëshuesin e dokumentit. Kjo përbën qasje formale dhe bie ndesh me nenin 36 të LPP. Sipas nenit 3 të LPP, kriteret duhet të jenë të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Interpretimi i AK redukton ekuivalencën vetëm në certifikime vendor hardëare fizik, përjashton arkitekturën hibride/cloud dhe vendos një barrierë hyrjeje që nuk është e lidhur drejtpërdrejt me objektin. Ky interpretim cenon konkurrencën efektive dhe trajtimin e barabartë. Në praktikë, AK ka aplikuar standard që vetëm certifikimi vendor hardëare fizik konsiderohet ekuivalent. Ky standard nuk është i shprehur në DST, nuk është sqaruar në fazën e pyetjeve, nuk është pjesë e dokumentacionit zyrtar. Sipas praktikës së KPP, ndalohet shtimi apo interpretimi restriktiv i kriterëve pas publikimit. Vendimi i AK nuk përmban analizë krahasimore teknike, nuk demonstroi se kompetencat e paraqitura nuk janë të barasvlershme dhe nuk përmbush standardin e arsytimit administrativ. Kjo cenon parimin e transparencës dhe të sigurisë juridike. OE ka provuar në mënyrë të plotë ekspertizë në arkitekturë infrastrukturore enterprise, në inteligjencë artificiale, përvojë në integrim sistemesh komplekse, dhe kompetencë në disponueshmëri të lartë dhe siguri. Kapaciteti teknik është real, i dokumentuar dhe i mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Në bazë të neneve 110 e vijues të LPP nga ana jonë kërkohet: 1. Pezullimi i menjëhershëm i procedurës; 2. 3. 4. Shfuqizimi i vendimit për moskualifikim; Rivlerësim objektiv dhe teknik i ekuivalencës; Rikthimi i OE në garë. Sipas gjykimit tonë vendimi i Autoritetit Kontraktor zbraz nga përmbajtja termin ose ekuivalente , vendos standard vendor-specific të pashprehur, aplikon kriter joproporcional dhe cenon konkurrencën.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në pikën 2.3.3 Kriteret e veçanta të kualifikimit, të shtojcës 9, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, të ndryshuar autoriteti kontraktor ka kërkuar;

*“2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (Dhjetë) punonjës të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, stafi të jete i*

vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatese si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave, nga te cilet:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate/system administrator ose ekuivalente;
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent;
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si specialist ne fushen AI Foundation ose ekuivalent;
- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave;
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit ose ekuivalente.
- i) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar HTML, CSS dhe JavaScript ose ekuivalente;
- j) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh ose ekuivalente.

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata te percaktuara si mësipërme.

Për të përmbushur këte kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Lidhur me kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, BOE ankimes “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin duke deklaruar si më poshtë:

-Kontratë bashkëpunimi Nr. 414 prot, datë 29.01.2026, ndërmjet shoqërisë “WOW Digital” sh.p.k & “First” sh.p.k. Ndarja e punimeve për secilën nga shoqëritë pjesë e këtij bashkimi operatorësh...e shprehur në përqindje ndarja e punimeve do të bëhet si më poshtë:

Shoqëria “WOW Digital” sh.p.k do të realizojë 15% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.



Shoqëria “First” sh.p.k do të realizojë 85 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara sipas preventivit për këtë objekt.

-Nga Verifikim ne SPE është dorëzuar ne kuadër të BOE dhe për funksion të kriterit 2.3.3, konkretisht si më poshtë:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “First” SHPK;
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “WOW DIGITAL” SHPK.
- Operatori ekonomik “Wow Digital” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Deklarata	Përgjigje						
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [ X ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve: 7</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <table border="1" data-bbox="760 1108 1339 1843"> <thead> <tr> <th data-bbox="760 1108 833 1205">Nr</th> <th data-bbox="833 1108 1045 1205">Emer Mbiemer</th> <th data-bbox="1045 1108 1339 1205">Diplomimi &amp; Certifikimet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="760 1205 833 1843">1</td> <td data-bbox="833 1205 1045 1843"></td> <td data-bbox="1045 1205 1339 1843"></td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Emer Mbiemer	Diplomimi & Certifikimet	1		
Nr	Emer Mbiemer	Diplomimi & Certifikimet					
1							

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Advanced React</li> </ul>
2		<p>Diplome Master i Shkencave ne Informatike Ekonomike me profil Finance Banke</p> <p>Diplome Master Profesional ne Informatike Biznesi</p> <p>Diplome Bachelor ne Inxhinieri Informatike</p> <p>Certifikime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Certifikate Testues Software</li> <li>Programim ne Web</li> </ul>
3		<p>Diplome e Integruar e Nivelit te Dyte ne Informatike</p> <p>Certifikime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Certifikate per Programin ne gjuhe C#, Asp.net</li> <li>Administrim i bazes se te dhenave, MySQL</li> <li>Bazat dhe principet i Inteligjences Artificiale</li> </ul>
4		Diplome Bachelor ne Inxhinieri

		matematike dhe informatike Certifikime: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Full-Stack Programming</li> <li>• JavaScript</li> <li>• React Native</li> </ul>
<u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ X ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:		
Emri, Mbiemri Firma Vula Data e dorëzimit të deklaratës: 30.01.2026		

- Gjithashtu operatori ekonomik “First” Shpk ka dorëzuar si më sipërkërkuar në kriterin 2.3.3:

dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.

Profili i punonjësve

Nr	Emer Mbiemer	Diploma dhe Certifikimet
1		<p>Diplome ne Inxhinieri Elektronike Drejtimi Telekomunikacion</p> <p>Certifikime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• PMP</li> <li>• CCNP Security</li> <li>• CSTA</li> </ul>
2		<p>Diplome Bachelor ne Inxhinieri Elektronike</p> <p>Certifikime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ITIL</li> </ul>
3		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diplome Bachelor ne Informatike Ekonomike me profil Finance dhe Banke</li> <li>• Diplome Master I Shkencave ne Teknologji Informacioi dhe Inovacioni;</li> </ul> <p>Certifikime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Microsoft Certified: Azure Security Engineer Associate</li> <li>• Microsoft Cybersecurity</li> </ul>

		Architect Expert
4		Diplome Bachelor ne Matematike Informatike
5		Diplome Bachelor ne Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital  Certifikime:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Microsoft Certified: Azure AI Engineer Associate</li> </ul>
6		Diplome Bachelor ne Inxhinieri Informatike
7		Diplome Bachelor ne Inxhinieri Kompiuterike dhe Teknologji Informacioni
8		Diplome Bachelor ne Informatike Ekonomik
9		Diplome Bachelor ne Informatike
10		Bachelor i Shkencave ne Teknologji Informacioni  Certifikime:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• ITIL</li> </ul>
11		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diplome Bachelor ne Inxhinieri Elektronike</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Diplome Master i Shkencave ne Inxhinieri Informatike</li> </ul>
		<p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [X]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
Emri, Mbiemri		
Firma		
Vula		
Data e dorëzimit të deklaratës: 30.01.2026		

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

II.2.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë

një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë*

*një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

*III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar

*në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6.Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar:

“Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (Dhjetë) punonjës të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informatike / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatëse si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave, nga te cilet:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente

- b) Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate/system administrator ose ekuivalente;
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent;
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi si specialist në fushën AI Foundation ose ekuivalent;
- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave;
- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit ose ekuivalente.
- i) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar HTML, CSS dhe JavaScript ose ekuivalente;
- j) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh ose ekuivalente.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanata të kualifikimit, BOE ankimes “WOW DIGITAL & First” sh.p.k ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.2.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimesi ka deklaruar sipas profileve të kërkuara.

Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*  
 h) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti*

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas*

*shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].*

Nisur nga sa parashtruar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetdeklarimit në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate”, Komisioni gjykon se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat respektive të kërkuar sipas pikës 2.3.5 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues “WOW DIGITAL & First” sh.p.k në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

*Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73471-12-29-2025, me objekt “Ndërtimi i platformës së inteligjencës artificiale si mjet mbështetës dhe analize për Operacionet e Operatorit të Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE)”, me fond limit 98,650,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30 01-2026 , nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
3. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori BOE “WOW DIGITAL & First” sh.p.k.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

